

SEKRETARIATI I KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

Progres i rekomandimeve të
Këshillit të Investimeve


Janar - Maj 2022

Komente kryesore:

Në krahasim me fundvitin e 2021, gjatë Janar - Maj 2022 vërejmë:

- Rritje me 2.7% të rekomandimeve të plotësuara* nga 40.5% (vitin e kaluar) në 43.2 % në Mars 2022. Specifikisht janë plotësuar në një masë 100% tre rekomandime nga mbledhja mbi E-leje dhe 1 rekomandim nga mbledhja mbi Promovimin e Investimeve në Agro përpunim.
- Rënie me 2.2 % e rekomandimeve të paplotësuara, nga 44.7- (vitin e kaluar) në 42.5 % aktualisht. Janë gjashtë rekomandime të paplotesuara që kanë kalua ne statusin në proces dhe implementuar.
- Rënie të ulël me 0.4% të rekomandimeve në proces, nga 14.7 % (vitin e kaluar) në 14.3 % aktualisht.

Figurë 1. Statusi i rekomandimeve të KI, Janar - Maj 2022




Gjatë periudhës Janar - Maj 2022 evidentohet progres pozitiv në 9 rekomandime:

- 7 të zbatuara*
- 2 në proces zbatimi.

Nga tre temat e trajtuara gjatë viteve 2020-2021, janë pesë rekomandime që kanë pasur ecuri positive, kryesisht në mbledhjet mbi "Inovacionin në sipërmarrje", "Ndërkombëtarizimin e SMEve" dhe "Promovimin e Investimeve në Agropërpunim".

Ndërsa nga temat më të hershme, ka pasur progres në një rekomandim të mbledhjes mbi "Rimbursimin e TVSH" dhe 3 rekomandime nga mbledhja mbi "E-lejet".

Figurë 2. Progresi i rekomandimeve të KI, Janar - Maj 2022



Fushat kryesore të ndërhyrjes ku evidentuam gjatë periudhës Janar- Maj 2022, veprime konkrete nga institucionet përgjegjëse, janë:

- ✓ *Përmirësime ligjore në drejtim të Inovacionit në sipërmarrje, si një sfidë për rritjen e konkurrueshmërisë dhe nxitës i rritjes ekonomike, përmes:*

a) Miratimit të pjesës më të madhe të legjislacionit sekondar në lidhje me zbatimin e Ligjit Nr. 55/2020, datë 30.04.2020 "Për Shërbimet e Pagesave" që u mundëson një grupi më të madh të institucioneve/agentëve të liçensuar përmirësimin e pagesave elektronike; Përmendim (1) miratimin e rregullores "Për regjistrin publik të ofruesve të shërbimeve të pagesave" (2) miratimin e rregullores së re "Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave", (3) disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin edhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", të cilat kryesisht konsistojnë në shtimin e disa kërkesave për agentët e bankave, kur këto të fundit veprojnë me agentë vetëm në cilësinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave.(4) disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin edhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", të cilat lidhen kryesisht me kërkesat për licencimin dhe miratimet paraprake për subjektet financiare jobanka që ofrojnë shërbime të

pagesave dhe të transferimit të parave, si dhe për institucionet e parasë elektronike, të cilat tashmë trajtohen në përputhje me kërkesat e reja ligjore dhe rregullative (5) disa ndryshime në rregulloren “Për licencimin edhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre”, të cilat sigurojnë përputhshmërinë me kërkesat e reja ligjore dhe rregullative. Tashmë Shoqëritë e Kursim - Kreditit (SHKK) që do të kryejnë veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave, do të pajisen me licencë të veçantë si institucion pagese, krahas licencës si SHKK (6) disa ndryshime në rregulloren “Për kërkesat minimale të sigurisë, në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare dhe për transportin e vlerave monetare”, të cilat sigurojnë përfshirjen në subjekte e kërkesave të kësaj rregulloreje edhe të institucioneve të pagesave dhe të institucioneve të parasë elektronike, ndërsa në rastin e bankave ato janë përgjegjëse për verifikimin e përmbushjes së kërkesave të rregullores nga agjentët e tyre, kur këto të fundit ofrojnë shërbimet e pagesave nëpërmjet agjentëve (7) miratimi i udhëzimit “Për kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme”

- b) *Miratimit të projektligjit "Për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Start-up Inovative",* që ndihmon në fuqizimin e ekosistemit të inovacionit dhe lidhjet midis palëve të interesuara përmes një kornize gjithëpërfshirëse ligjore dhe rregullative. Në vijim të këtij procesi, është mjaft e rëndësishme të miratohet edhe legjislacioni sekondar i lidhur me këtë ligj. Që rekomandimi të konsiderohet plotësisht i implementuar, duhet të konsiderohen për zbatim edhe (1) krijimi i një liste të konsoliduar të incentivave jodiskriminues administrative dhe financiare në dispozicion të investitorëve të huaj dhe vendas si një parakusht për konkurrencën e ndershme (2) një regjim vetë-rregullues të qeverisjes së ekosistemit bazuar në struktura si psh Bordi i Vlerësimit për bizneset Inovative start-up me anëtarë të shumicës nga sektori privat (3) ngritja e një portali elektronik në internet, i hapur, transparent dhe lehtësisht i aksesueshëm për Start-Ups Inovative (4) krijimi i një Fondi Kombëtar për Inovacionin që mbështet aksesin në kreditim për inkubatorët e certifikuar dhe start-up inovativë përmes garancive për huatë bankare.
- ✓ *Përmirësim ligjor në drejtim të nxitjes së investimeve në agro-përpunim.* Konkretisht, rekomandimi lidhet me nevojën për ndryshime dhe harmonizim të ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” me dispozitat e Rregullores së BE 2018/848 “Për prodhimin organik”. Në shkurt 2022 për bujqësinë organike, është arritur progres në përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për prodhimin organik me acquis të BE –së, ku është miratuar ligji 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” dhe është plotësuar edhe me aktet nënligjore pothuajse plotësisht.
- ✓ *Përmirësim i mëtejshëm i funksionaliteteve të platformës E-leje, përmes*
 - a) finalizimit të punës për përgatitjen e një manuali të detajuar operacional, teknik dhe ligjor në formën e një udhëzimi për të gjithë përdoruesit, përfshirë Bashkitë dhe AIDA si institucione të cilat promovojnë shërbimet me një ndalesë të platformës tek investitorët potencialë.
 - b) konfirmimit të përfundimit të ndryshimeve ligjore të rekomanduara në vitin 2018 referuar ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” që është

shfuqizuar tashmë dhe miratuar Ligji 111/2018 “Për kadastrën”. Institucionet si KKA, KKR dhe KKK tashmë secila kanë aplikimin e vet online dhe miratimet përkatëse merren në E-albania, sipas ëorkfloë-ve specifike. Bazuar në ligjin nr.8402/1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” (i ndryshuar) janë bërë ndryshimet e fundit me Ligjin Nr. 120/2020 dhe IKTK dhe KTKMK janë pjesë e institucioneve në sistemin e leje, si dhe çdo intitucion tjetër që duhet apo mund të përgjigjet sipas fushës së vet të kompetencës.

- c) trajnimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore të cilat janë të përfshira direkt në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit nëpërmjet platformës e-Leje. Specifikisht vëmendje i është kushtuar këtij procesi, nga Drejtoria e NJQV-së, e cila është ngritur pikërisht për asistencë e trajnim ndaj NJQV-ve.

- ✓ *Thjeshtimi i mëtejshëm i procedurave të rimbursimit të TVSH-së*, përmes mundësit që nga dt. 7 mars 2022 që çdo kërkesë për rimbursimin e TVSH-së të bëhet vetëm online, përmes Platformës Dixhitale të Rimbursimit të TVSH-së. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vuri në dispozicion udhëzuesin, që orienton tatimpaguesit hap pas hapi për mënyrën sesi duhet të përdoret platforma online e rimbursimit.

Dy rekomandimet e konsideruara në proces, lidhen me temën e “Ndërkombëtarizimit të SMEve” e trajtuar në fund të vitit 2021 në KI dhe bazohen në komentet e marra nga përfaqësuesit e MFE në disa grupe pune të ngritura mes strukturave të MFE, ekspertëve të fushave përkatëse dhe dhomave e platformave që kanë propozuar ndërhyrje për nxitjen e Investimeve. Konkretisht na është konfirmuar, që

- ✓ Është krijuar Grupi i Punës për hartimin e Programit të Eksporteve dhe në kuadër të këtij Grupi Pune, po punohet për hartimin e një pyetësi drejtuar bizneseve për një vlerësim që synon verifikimin e NMVM-ve eksportuese dhe NMVM-ve me potencial dhe gatishmëri për t’iu qasur tregjeve të huaja sipas sektorëve prioritarë. Brenda vitit 2022 pritet të përfundojë Programi i Eksporteve. Për industrinë e zgjedhura do të kryhen vlerësime të tjera tregu për të identifikuar nxitësit kryesorë të avantazhit konkurrues, potencialet e tjera për diversifikimin e produkteve, tregjet e synuara, dhe strategjitë për pozicionimin e duhur dhe hyrjen në treg.
- ✓ Nga MFE, po punohet në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të sipërmarrësve të NMVM-ve për kosto/përfitim në përdorimin e opsioneve alternative të energjisë. Kështu gjatë periudhës Prill- Maj janë planifikuar disa ëorkshope me tema “Menaxhimi i Mbetjeve në Hotele dhe Strukturat Akomoduese”, “Përfitimet e përdorimit të sistemeve Fotovoltaike në sektorin e turizmit”, “Zbatimi i masave të eficientës në energji dhe për menaxhimin e mbetjeve në sektorin e turizmit”, “Rast studimor për zbatimin e masave të eficientës në energji, energjisë së rinovueshme dhe sistemeve të menaxhimit të mbetjeve”.

Janë aktualisht 116 rekomandime të paplotësuara për të cilat gjatë këtij pese muajori, është kontaktuar me institucionet përgjegjëse dhe jemi në pritje të komenteve dhe përgjigjeve të tyre formale. Ndër institucionet që zënë peshën më të madhe në zbatim të rekomandimeve të papërmbluara janë:

- ✓ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – 12 rekomandime
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit – 14 rekomandime

- ✓ Agjencia Shtetërore e Kadastrës – 16 rekomandime
- ✓ Inspektoriati Qendror – 13 rekomandime
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve – 10 rekomandime